

# ISEAL, pikë referimi për çështjen shqiptare

## Themelohet Institut i zviceran i studimeve shqiptare - ISEAL

Nga muaji nëntor 2010, një ekip i vogël, i shoqëruar nga afér nga Këshilli i Fondacioni ISEAL, do të vërë në veprim vendosjen e strukturave të ISEAL-it.

Bernë, 20 PRILL - Themelohet instituti zviceran i studimeve shqiptare ISEAL-i. Institut ka për qëllim zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, të ndihmojë integrimin e shqiptarëve në Zvicër, të bëhet një partner i njohur prej autoriteteve të Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe të shërbejë si pikë referimi për vende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjen shqiptare. Fondacioni ISEAL ndjek qëllimet me vlerë publike, duke përjashtuar çdo qëllim përfitimi. Për t'i arritur qëllimet e tij, ISEAL-i do të shfrytëzojë një Institut Shkencor me 4 sektorë. Në fushën e kërkimeve ku do të bëjë kërkime në fusha të ndryshme, si: formimi, integrimi, politika, gjuhësia, sociologjia, ekonomia, kultura, historia, gjeografia dhe teologjia. Në fushën e botimeve, ku do të botojë vepra periodike, libra, broshura dhe bulletine të tjera (në gjermanisht, frëngjisht, italisht, shqip etj.). Në mësimdhënie, ku do të ofrojë mësimdhënie, e cila do të përfundojë me formime të vërtetuara ose me kredi ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System). Në fushën e dokumentimit, ku do të bashkëpunojë me universitetet, shkollat e larta, bibliotekat dhe autoritetet e Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë si dhe me institute të ndryshme private apo publike. Anëtarët themelues të ISEAL-it janë: Zonja Barbara BURRI-SHARANI, psikologe, Zonja Magaly HANSELMANN, koordinatore e kantonit Vaud në fushën e integrimit të të huajve dhe parandalimit të racizmit, Prof. Dr. Doris JAKUBEC, ish drejtoreshë e Qendrës së Kërkimeve Letrare të Zvicrës Franceze, M. Daniel ABIMI, gazetar, M. Francis COUSIN, ish-ambasador, M. Drilon KAJTAZI, autor dhe mësimdhënës, Prof. Dr. Peter KNOEPFEL, Profesor titullar i katedrës së politikave publike, afatgjata e zhvillimore pranë IDHEAP-it, Dr. Régis MARION-VERYON, mjek-psikiatër, M. Bruno MIGLIARINI, kuadër bankar, M. Victor RUFFY, gjeograf, ish-kryetar i Parlamentit Zviceran, Prof. Dr. Basil SCHADER, profesor në SHLP në Cyrih. ISEAL-është njohur nga autoritetet e Konfederatës zvicerane, si Institut me Vlerë Publike.